



Pranuar / Dorëzuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	28.12.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSICK	6371/2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.922/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.922/2021 të datës 12.11.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati “Dobërlluk”, në Komunën e Vushtrrisë, kundër Vendimit me Nr. 1245 të datës 27.10.2021 të protokolluar më datë 08.11.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike “transferim” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.922/2021 e datës 12.11.2021, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr. 1245 i datës 27.10.2021 i protokolluar më datë 08.11.2021 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit të datës 01.12.2011 në pozitën “Menaxher i Prokurimit” në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 14.02.2019 ka parashtruar kërkesë për transferim të përhershëm nga pozita Menaxher i Prokurimit në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve, në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 25.02.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. 273 me të cilin ankuesin e ka transferuar në mënyrë të përhershme nga pozita „Menaxher i Prokurimit” në pozitën „Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve”.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 27.10.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 1245 të protokolluar më datë 08.11.2021, me të cilin ankuesin nga Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve e ka sistemuar në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Programe, Regjime dhe

Çështje Sociale në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë me arsyetim që pozita „Udhëheqës i Trajnimeve” nuk është paraparë me Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizmin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa pozita „Udhëheqës i Sektorit për Programe, Regjime dhe Çështje Sociale” në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë është e lirë.

Ankuesi, kundër Vendimit me Nr. 1245 të datës 27.10.2021 të protokolluar më datë 08.11.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, fizikisht më datë 12.11.2021 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot:5412/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kthim në pozitën Menaxher i Prokurimit, po ashtu pretendon që institucioni nuk ka themeluar komision ristrukturimi pasi që në vendim baza ligjore është neni 54 i Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.11.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 19.11.2021 ka dërguar provat e kërkuara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 5412/2021 e datës 12.11.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit e datës 01.12.2011; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 25.02.2019; Vendimin me Nr. 1245 të datës 27.10.2021 të protokolluar më datë 08.11.2021 të Zëvendësit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.11.2021; Përgjigjen në ankesë e datës 19.11.2021; Vendimin me Nr. 273 i datës 25.02.2019; Kërkesën për transfer të përhershëm e datës 14.02.2019 nga ankuesi; Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizmin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë; Skema e Organizimit të Brendshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën e datës 10.12.2021 dhe përgjigjen në kërkesë e datës 10.12.2021; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 02.12.2021 .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e parashtruar nga ankuesi është, e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon për kthim në pozitën Menaxher i Prokurimit, po ashtu pretendon që institucioni nuk ka themeluar komision ristrukturimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, konstaton se, ankuesi në bazë të shkresës-kërkesës së datës 14.02.2019, ka kërkuar të transfer të përhershëm nga pozita „Menaxher i Prokurimit” në pozitën „Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve” me zyre ne Akademinë e Sigurisë Publike, dhe në kuptim të kësaj me Vendim të datës 25.02.2019, ankuesi është transferuar nga pozita „Menaxher i Prokurimit” në pozitën „Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka kërkuar informata përmes e-mailit te datës 10.12.2021 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës se a është plotësuar pozita e „Menaxher i Prokurimit” pas transferimit te ankuesit dhe pas përgjigjes dhe dëshmive të ofruara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, konstatohet se pozita „Menaxher i Prokurimit” është plotësuar me nëpunës



civil të karrierës dhe se akt emërimi i është lëshuar zyrtarit të përzgjedhur me date 06.06.2019, andaj Kolegji konstaton se rrjedhimisht pretendimi i ankuesit për kthim në atë pozitë është i pamundur, sepse përveç që e njëjta është pozitë e plotësuar, ankuesi me vullnetin e tij ka kërkuar të transferohet në një pozitë tjetër.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ne baze të dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit dhe ankuesi pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor lidhur mos themelimin e komisionit për ristrukturimi nga ana e institucionit, ka konstatuar se Rregullorja QRK-Nr.31/2013 për Organizmin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, është në fuqi nga viti 2013, kështu që në bazë të kësaj pozita „Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve” nuk është e paraparë si pozitë me këtë rregullore dhe me organogram, dhe ankuesi edhe pse është transferuar në një pozitë që nuk është paraparë me organogram të institucionit në bazë të provave të lëndës asnjëherë nuk ka shprehur ndonjë pakënaqësi dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim ligjor lidhur me këtë çështje.

Meqenëse nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, është konstatuar fakti që pozita „Udhëheqës i Divizionit të Trajnimeve” nuk është e paraparë si pozitë në Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizmin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë, atëherë medoemos ka qenë e nevojshme që të bëhet sistemimi i ankuesit në një pozitë që është e lirë dhe që është përfshirë në organogramin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, kështu që më datë 08.11.2021 është nxjerr Vendimi me Nr. 1245 me të cilin ankuesi është caktuar në pozitën „Udhëheqës i Sektorit për Programe, Regjime dhe Çështje Sociale” në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë. Bazuar në Rregulloren QRK-Nr.31/2013 për Organizmin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë pozita „Udhëheqës i Sektorit për Programe, Regjime dhe Çështje Sociale” është paraparë në kapitullin e IV respektivisht me nenin 69 dhe 73 të kësaj rregulloreje, dhe mbi bazë të kësaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se meqë pozita Udhëheqës i Sektorit për Programe, Regjime dhe Çështje Sociale ka qenë pozitë e lirë dhe nuk ka asnjë dëshmi që brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës është bërë shuarje apo ristrukturim i institucionit, respektivisht është bërë ristrukturim apo shuarje e pozitave, atëherë në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nuk ka qenë e nevojshme të bëhet komision ristrukturimi, sepse komisioni i ristrukturimit bëhet vetëm në rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit, siç parashihet me nenin 54 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: ***“Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta...”***

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se në bazë të Vendimit me Nr. 1245 të datës 27.10.2021 të protokolluar më datë 08.11.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me të cilin ankuesi është caktuar në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Programe, Regjime dhe Çështje Sociale në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë, i njëjti nuk është dëmtuar në pagë, sepse në bazë të dëshmisë se ofruar nga organi i punësimit konkretisht formularit të dhënave nga lista e pagave e datës 02.12.2021 kompensimi për ankuesin është dërguar me koeficient nëntë (9), andaj bazuar në këtë të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.922/2021

Avdyll BEKTESHI

per i chukur
Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

M. Gashi
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit*
- *Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së;*

